



01 Nr. 516/25 Dt. 02.09.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejin e realizimit të projektit: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të shërbimit të zjarrfikëseve në Komunën e Prizrenit", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë-mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.